



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 771 / prot.
1

Tiranë më 9.07.2020

Lënda: Mendim mbi një projektligj

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 11844/1 Prot., datë 23.06.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin "*Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit*", më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me qëllim garantimin e masave për sigurinë e të dhënave personale, që do të përpunohen në Qendrën e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, sugjerojmë që, pas pikës 1, të nenit 31 të projektligjit, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: "*Baza elektronike e Qendrës së Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohen masat për sigurinë e të dhënave personale, parimi i mjaftueshmërisë, proporcionalitetit si dhe konfidencialiteti lidhur me përpunimin e të dhënave personale.*"

Nga pikpamja e teknikës legislative dhe me qëllim unifikimin e terminologjisë me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", (në vijimi "*ligji për mbrojtjen e të dhënave personale*"), sugjerojmë që pika 6, e nenit 31 të projektligjit, të ndryshohet si vijon: "*Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale, do të kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.*"

Me tej, me qëllim reflektimin drejt të parimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që pas pikës 4, të nenit 32 të projektligjit, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: "*Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente do të kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.*"

Gjithashtu, në respektim të nenit 18 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që pas pikës 6, të nenit 32 të projektligjit, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: *“Qendra e Informacionit të Sigurimit të Detyrueshëm, duhet të informojnë subjektin e të dhënave për të gjithë procesin e përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve ligjore.”*

Së fundmi, Zyra e Komisionerit propozon hartimin e një akti nënligjor në funksion të rregullimeve specifike të përpunimit të të dhënave personale në këtë fushë, duke qënë se potencialisht mblidhen dhe përpunohen një gamë e gjerë të dhënash personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

